



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

NR. 60, Datë 05.04.2019

**PËR SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT PËR PROKUROR PRANË PROKURORISË
SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, të nenit 166, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të nenit 7 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të nenit 47 pika 1, gërma b të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

- I. Të skualifikojë Z. Fatmir Hoxhaj, kandidat për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, i cili pas vlerësimit paraprak rezulton se aktualisht nuk është pjesë e sistemit të prokurorisë, duke mos plotësuar kushtet ligjore për ngritjen në detyrë, parashikuar në nenin 47 pika 1, gërma b të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *“Ngritja në detyrë është kalimi nga një pozicion i juridiksionit të përgjithsëm civil, penal ose administrative në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme”*.
- II. Të njoftohet me këtë vendim Z. Fatmir Hoxha.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT I BRAHIMI

ZV/KRYETARI

ALFRED BALLA





ANËTAR

ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR

GENTJAN OSMANI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

BESNIK CANI

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR

TARTAR BAZAJ